

VENDIM
Nr. 610, datë 7.7.2015

**PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E FONDEVE PËR VEPRIMTARI
SPECIFIKE OPERATIVE TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË
MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për realizimin e veprimtarive specifike operative, të përdorë fondet për veprimtari specifike operative të miratuara për këtë qëllim.
2. Fondet për veprimtari specifike operative të jenë deri në 25 për qind të buxhetit vjetor të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
3. Fondet për veprimtari specifike operative të përdoren, në vlerë leku dhe në valutë, për:
 - a) shpenzime për sigurimin e informacionit dhe mbështetjen e veprimtarisë operative;
 - b) shpenzime për pagesën dhe shpërblimin e burimeve të informacionit;
 - c) blerje të mallrave, shërbimeve, pajisjeve, mjeteve e programeve, në funksion të veprimtarive specifike operative, si dhe për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;
 - ç) marrje me qira të objekteve dhe të mjeteve, në funksion të veprimtarive specifike operative;
 - d) shpenzime për takime me përfaqësues të shërbimeve të huaja të inteligjencës, në interes të shkëmbimit të informacionit dhe kryerjes së veprimtarive të përbashkëta operative;
 - dh) shpenzime për trajnime specifike të personelit të strukturave operacionale;
 - e) shpenzime për kompensimin e familjes së personit që humb jetën për shkak të bashkëpunimit të fshehtë me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
4. Kontrolli financiar për programimin dhe përdorimin e fondeve për veprimtari specifike operative kryhet nga persona të autorizuar, nga:
 - a) Kryeministri dhe ministri i Mbrojtjes, të paktën, një herë në dy vjet;
 - b) drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të paktën, një herë në vit.
5. Personat e autorizuar nga autoritetet e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, për kryerjen e kontrollit të fondeve për veprimtari specifike operative të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie personeli të nivelit “Tepër sekret”.
6. Kontrolli të ushtrohet duke respektuar legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.
7. Vendimi nr. 162, datë 18.3.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin dhe kontrollin e fondit për veprimtari të specifike të Shërbimit Informativ Ushtarak”, shfuqizohet.
8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama